



16 shkurt 2017

KOMUNIKATË PËR MEDIA

MBLEDHJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË AKP-SË

Prishtinë – Agjencia Kosovare e Privatizimit do të shpërndajë shumën prej 718 mijë e 550 euro për kreditorët e tri ndërmarrjeve shoqërore (N.Sh) që janë në likuidim: “Plantacioni i Pemëve”, Gjilan; “N.Sh 28 Nëntori”, Gjilan dhe “KB Rakosh”, Pejë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së e mori këtë vendim të rëndësishëm për përmbylljen e procesit të likuidimit të këtyre ndërmarrjeve në mbledhjen e fundit të mbajtur, në vazhden e aktiviteteve të Bordit për ta përshpejtuar procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në vend.

Në këtë kuadër, Bordi aprovoi transaksionet e shitjeve për Shitjet e Aseteve në Likuidim nr. 28, që u zhvillua me sukses gjatë muajit janar, ndërkohë që miratoi edhe shpalljen e valës së re të Shitjes së Aseteve në Likuidim nr. 30, e cila përfshinë rreth 60 asete të N.Sh-ve në gjithë territorin e Kosovës. Në përputhje me zotimin e Bordit të Drejtorëve për ta dinamizuar procesin e likuidimit të N.Sh-ve, gjatë kësaj mbledhje të mbajtur Bordi vendosi në likuidim edhe 24 ndërmarrje të tjera shoqërore.

Ndër të tjera, Bordi miratoi edhe raportin e Komisionit për Shitje të Banesave me gjithsej 14 kërkesa të shqyrtuara, si dhe miratoi edhe një numër të qiradhënieve të aseteve të N.Sh-ve, ndërkaq vendosi për të anuluar tenderin për qiradhënie të një numri prej 20 aseteve të INA-së dhe Jugopetrolit.

Bordi e shqyrtoi raportin e përmbushjes së kushteve të kontratës për ndërmarrjen e privatizuar me kushte, Ndërmarrja e Re “Fabrika e amortizatorëve”, dhe në bazë të raportit të auditorit të jashtëm të pavarur dhe raporteve të monitorimit konkludoi se blerësi nuk ka më obligime kontraktuale ndaj Agjencisë.

Gjatë këtij takimi, Bordi aprovoi disa akte nënligjore, ndër të cilat edhe Rregulloren për qasje në dokumente zyrtare dhe klasifikim të informacionit, duke ritheksuar me këtë rast përkushtimin e Agjencisë që paralelisht me rritjen e aktiviteteve të rritet edhe transparenca në raport me publikun.

Gjatë mbledhjes së mbajtur Bordi u informua lidhur me vizitën e realizuar ditë më parë nga anëtarë të Bordit dhe nga Menaxhmenti i AKP-së në ndërmarrjen “Boksitet e Kosovës” dhe MIM Golesh, me qëllim të njoftimit nga afër me gjendjen në terren, të sfidave si dhe potencialet që ekzistojnë për zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve me rëndësi për zhvillim ekonomik të vendit.

FUND